

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8337
E premte, 10 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

Haradinaj kërkon që
Kosova ta synojë diskutimin
e anëtarësimit në NATO
në samitin e Tiranës **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI FTON 'OPOZITËN' NË TAKIM, HAMZA E ABDIXHIKU PRANOJNË, GJINI REFUZON **FAQE 4-5**



Kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë për takim kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, atij të LDK-së, Lumir Abdixhiku,

dhe kryetarit të Aleancës, Ardian Gjini, për të diskutuar për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 7 qershorit. Kësaj ftese i

janë përgjigjur pozitivisht Hamza dhe Abdixhiku, ndërsa Gjini ka thënë se nuk e shih të nevojshëm takimin me Kurtin

AKTUALE



**RAMIZ KELMENDI NDEROHET PËR
22 VJET BASHKËPUNIM ME ODËN
EKONOMIKE AMERIKANE F. 7**

**SHSKUK-SË I BASHKOHEN
17 ANESTEZIOLOGË TË RINJ F. 7**

**KOSOVA EKSTRADON NË SUEDI NJË
PERSON TË KËRKUAR PËR
TRAFIKIM ME NARKOTIKË F. 6**

EKONOMI



**BE-ja MIRATON PROJEKTE DHE
GRANTE PREJ 206 MILIONË EUROSH
PËR KOSOVËN F. 8**

**HAXHIU VIZITON ZKA-në: DO TA
MBËSHITESIM TRANSPARENCËN DHE
MENAXHIMIN E PËRGJEGJSHËM TË
PARASË PUBLIKE F. 8**

SPORT



**ALBION RRAHMANI BËHET LOJTAR
I KLUBIT ITALIAN VENEZIA F. 11**

**GJYKATAT
NË VERI ENDE
PA GJYOTARË
E PROKURORË
SERBË: A KA
ZGJIDHJE? F. 3**



**KONJUFCA
TAKON
ZYRTARIN E
LARTË ITALIAN,
NË FOKUS
INTEGRIMI NË
BE DHE NATO F. 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UKRAINA MERR DRITËN JESHILE PËR TË PRODHUAR RAKETA 'PATRIOT'

KIEV, 9 KORRIK - Ukraina ka marrë një sinjal të rëndësishëm politik nga Shtetet e Bashkuara për të prodhuar raketat interceptuese të sistemit amerikan të mbrojtjes ajrore "Patriot", në një kohë kur sulmet ruse me raketa balistike janë intensifikuar dhe rezervat ukrainase të këtyre raketave po shterojnë.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, e siguroi këtë mbështetje gjatë takimit me presidentin amerikan Donald Trump në margjinat e samitit të NATO-s në Turqi. Trump ka thënë se Uashingtoni do t'i japë Ukrainës licencën për prodhimin e raketave "Patriot", duke shtuar se në këtë mënyrë Kievi do të mund të prodhojë vetë raketat që i nevojiten për mbrojtjen ajrore.

Ky premtim vjen në një periudhë kur Ukraina po përballet me sulme gjithnjë e më intensive nga Rusia. Vetëm gjatë javës së fundit, Kievi është bombarduar disa herë me dronë, raketa lundruese dhe raketa balistike, ndërsa sulmet kanë shkaktuar viktima dhe dëme të mëdha në infrastrukturë.

Sipas autoriteteve ukrainase, mbrojtja ajrore ka përmirësuar ndjeshëm aftësinë për të rrëzuar dronët dhe raketat lundruese, por vazhdon të ketë vështirësi serioze në ndalimin e raketave balistike.

Vlerësimet tregojnë se Ukraina

ka arritur të rrezojë rreth 90 për qind të dronëve rusë me reze të gjatë veprimi dhe rreth 80 për qind të raketave lundruese të lëshuara nga Rusia gjatë këtij viti. Megjithatë, situata është shumë më sfiduese përballë raketave balistike. Nga qindra raketa balistike të lëshuara nga Rusia këtë vit, shumica kanë arritur objektivat e tyre, pasi Ukraina nuk ka pasur mjaftueshëm raketa interceptuese për t'i ndaluar.

Arma balistike që Rusia përdor më shpesh është raketa tokë-tokë "Iskander-M", e cila ka reze veprimi rreth 500 kilometra dhe lëviz me shpejtësi shumë të lartë. Po ashtu, Rusia ka përdorur edhe raketat hipersonike "Tsirkon", të cilat janë shumë të vështira për t'u interceptuar. Gjatë një prej sulmeve të fundit, sipas Forcave Ajrore të Ukrainës, asnjë nga raketat "Iskander-M" nuk u rrëzua, ndërsa edhe raketat "Tsirkon" goditën objektivat e tyre.

Zëdhënësi i Forcave Ajrore të Ukrainës, koloneli Yuriy Ihnat, ka thënë se vendi nuk ka mungesë të sistemeve të mbrojtjes ajrore, por të raketave interceptuese për sistemin "Patriot". Sipas tij, Rusia është e vetëdijshme për mungesën globale të këtyre raketave dhe po e shfrytëzon këtë situatë duke rritur përdorimin e raketave balistike.

Sistemi "Patriot", i prodhuar



nga kompanitë amerikane Lockheed Martin dhe RTX Corporation, konsiderohet mjeti më efektiv për mbrojtjen nga raketat balistike. Një bateri përfshin radarë, qendër komandimi, lëshues raketash, antena dhe pajisje të tjera mbështetëse, ndërsa kostoja e një sistemi të plotë arrin rreth 1.1 miliard dollarë. Ukraina besohet se disponon të paktën shtatë sisteme "Patriot", të siguruar nga Shtetet e Bashkuara, Gjermania dhe aleatë të tjerë evropianë, megjithëse jo të gjitha janë funksionale në të njëjtën kohë për shkak të mirëmbajtjes.

Krahas "Patriot", Ukraina përdor edhe sistemin franko-italian SAMP/T, i cili është efektiv kundër dronëve dhe raketave lundruese, por konsiderohet më pak i besueshëm përballë raketave balistike.

Prej muajsh, autoritetet

ukrainase kanë kërkuar leje nga ShBA-ja për të prodhuar vetë raketat interceptuese "PAC-2" dhe "PAC-3". Një diplomat i lartë i NATO-s ka thënë se Ukraina beson se mund të zhvillojë një raketë të ngjashme me modelin "PAC-2" brenda më pak se një viti dhe ta prodhojë në sasi të mëdha.

Megjithatë, ekspertët mbeten skeptikë. Ish-oficeri ukrainas i mbrojtjes ajrore, Valeriy Romanenko, ka thënë se prodhimi me licencë i raketave më moderne "PAC-3" do të jetë shumë i vështirë për shkak të sulmeve të vazhdueshme ruse ndaj industrisë ukrainase dhe mungesës së komponentëve të nevojshëm.

Edhe studiuesja amerikane Jennifer Kavanagh ka thënë se miratimi politik nuk është i mjaftueshëm për ta bërë projektin realitet. Sipas saj, Ukraina duhet të ndërtojë objekte prodhimi që

përbushin standardet amerikane, të sigurojë komponentët e nevojshëm dhe të kalojë procedura të shumta ligjore. Ajo ka thënë se, edhe në skenarin më optimist, prodhimi do të nisë në sasi të kufizuara dhe vetëm pas një ose më shumë vitesh, prandaj nuk do të ndikojë në mbrojtjen afatshkurtër të Ukrainës.

Kavanagh ka thënë gjithashtu se ekziston rreziku që teknologjia e ndjeshme amerikane të përfundojë në duart e Rusisë ose Kinës, nëse transferohet në Ukrainë.

Nga ana tjetër, Romanenko ka thënë se një zgjidhje më efektive do të ishte furnizimi i Ukrainës me raketa me reze të gjatë veprimi për të goditur fabrikat ruse të armëve dhe njësitë që lëshojnë raketa balistike. Ai ka përmendur raketat amerikane "Tomahawk" si një nga opsionet që do të ndihmonte në dobësimin e kapaciteteve ushtarake ruse. Ndërkohë, industria ukrainase e mbrojtjes po punon edhe për alternativa vendase. Kompania ukrainase "Fire Point" ka njoftuar se ka testuar me sukses sistemin e ri të mbrojtjes ajrore "Frya", i cili synon të plotësojë, ose në të ardhmen edhe të zëvendësojë, sistemin "Patriot". Megjithatë, analistët vlerësojnë se do të duhen edhe disa muaj para se sistemi të jetë plotësisht operacional dhe i gatshëm për përdorim në fushën e betejës.

SHBA-ja KRYEN SULME TË REJA NË IRAN, TEHERANI HAKMERRET ME SULME NË KUAJIT DHE BAHREJN

UASHINGTON, 9 KORRIK - Ushtria amerikane ka njoftuar se ka kryer sulme të reja ndaj Iranit me qëllim që të mbajë të hapur për lundrim ngushticën e Hormuzit, pasi Uashingtoni e akuzon Teheranin për sulmin ndaj tri anijeve tregtare që po kalonin në këtë rrugë detare. Përshkallëzimi i ri i tensioneve ka rritur shqetësimet se përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund konfliktit mund të dështojnë.

Komanda Qendrore e ShBA-së (CENTCOM) ka thënë se sulmet synojnë të dobësojnë aftësinë e Iranit për ta kërcënuar lirinë e lundrimit në Ngushticën e Hormuzit, një prej korridoreve më të rëndësishme detare për tregtinë globale të naftës. "Shtetet e Bashkuara e mbajnë Iranin përgjegjës për agresionin ndaj anijeve tregtare dhe

ekuipezheve civile që lundrojnë lirshëm në këtë rrugë jetike ndërkombëtare", ka thënë CENTCOM.

Sipas raportimeve, sulmet amerikane goditën disa qytete përgjatë bregdetit jugor të Iranit, ndërsa në disa zona u ndërpre furnizimi me energji elektrike. Irani u kundërpërgjigj duke kryer sulme ndaj Kuvajtit dhe Bahrejnit, dy shtete që strehojnë baza ushtarake amerikane. Kjo ishte dita e dytë radhazi që Teherani sulmoi këto vende.

Ministria e Mbrojtjes e Kuvajtit ka thënë se sistemet e mbrojtjes ajrore kanë interceptuar raketa dhe dronë, ndërsa Katar i lëshoi përkohësisht një alarm për rritje të rrezikut të sigurisë, përpara se të njoftonte se situata ishte stabilizuar.

Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump ka thënë në



platformën "Truth Social" se sulmet përbënin hakmarrje për bombardimin e anijeve nga Irani dhe ka paralajmëruar pasojë edhe më të rënda nëse incidente të tilla përsëriten.

Ngushtica e Hormuzit mbetet një nga rrugët më të rëndësishme për transportin e

naftës në botë. Para fillimit të konfliktit, rreth një e pesta e furnizimit global me naftë kalonte përmes saj, duke i dhënë Iranit ndikim të konsiderueshëm mbi tregjet energjetike dhe sigurinë detare në rajon. Megjithëse Irani nuk ka marrë përgjegjësinë për sulmet

ndaj anijeve tregtare, analistët vlerësojnë se Teherani përdor veprime të tilla për të rritur presionin në negociatat me Shtetet e Bashkuara.

Negociatori kryesor iranian, Mohammad Baqer Qalibaf, ka thënë se ShBA-ja duhet të kuptojë se kërcënimet nuk mbeten pa pasojë.

Përshkallëzimi i fundit ka zbehur edhe më tej shpresat për ta kthyer memorandumin e mirëkuptimit, të nënshkruar më 17 qershor, në një marrëveshje të përhershme për përfundimin e konfliktit, i cili nisi me sulmet amerikano-izraelite ndaj Iranit më 28 shkurt. Para samitit të NATO-s në Turqi, Trump ka thënë se, sipas tij, memorandumi i mirëkuptimit ka marrë fund dhe se nuk dëshiron të merret më me Iranin.

KURTI FTON "OPOZITËN" NË TAKIM, HAMZA E ABDIXHIKU PRANOJNË, GJINI REFUZON

Kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë për takim kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, atij të LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe kryetarit të Aleancës, Ardian Gjini, për të diskutuar për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 7 qershorit. Kësaj ftese i janë përgjigjur pozitivisht Hamza dhe Abdixhiku, ndërsa Gjini ka thënë se nuk e sheh të nevojshëm takimin me Kurtin

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryeministri në detyrë dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë për takim kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza, atij të LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe kryetarit të Aleancës, Ardian Gjini, për të diskutuar për formimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 7 qershorit. Kësaj ftese i është përgjigjur pozitivisht Bedri Hamza, i cili ka thënë se është i gatshëm të takohet sot (e premte) në orën 09:00. Ftesa e Kurtit është refuzuar nga Ardian Gjini i Aleancës.

Letra e Kurtit dërguar krerëve partiakë vjen pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të qershorit. Pas mbledhjes së Kryesisë së partisë, Hamza ka thënë se Kurti në letrën e tij kishte propozuar që takimi të mbahej të enjten në orën 17:00, apo sot (e premte) në orën 08:00, 09:00 ose 18:00. "Unë ia ktheva shkresën që PDK-ja është e gatshme të takohet në orën 09:00 në ambientet e Kuvendit", ka thënë Hamza.

Ai ka thënë se vendi po përballet me vakum institucional dhe se të gjithë duhet të sillen në mënyrë të përgjegjshme. "Nuk jam kundër që të ketë takime, mirëpo para se të flasim për pozitë, e kam thënë dhe po e përsëris, janë tepër të rëndësishme prioritetet, vizioni për të ardhmen, programi, adresimi i sfidave të cilat i ka Kosova. Nëse nuk ka dakordim për këto, nuk është qëllimi i PDK-së t'i ketë një numër të caktuar të ministrive, ta ketë një kryetar të Kuvendit apo presidentin apo çfarëdo qoftë", ka thënë Hamza.

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se do t'i përgjigjet pozitivisht ftesës së Kurtit. "Besoj që kohën e aranzhojnë ekipet tona. Por, ky le të jetë një takim i parë. Do të provoj të takohem edhe me liderët e partive politike", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se dëshiron trajtim gjithëpërfshirës për krijimin e të gjitha institucioneve.

I pyetur nëse LDK-ja do të insistojë që ta ketë presidentin, pasi kanë garuar me ish-



presidenten Vjosa Osmani për këtë post, Abdixhiku ka thënë: "Në këtë fazë nuk do të flasim për emra. Do të dëgjojmë edhe palën tjetër", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se është e rëndësishme të tentohet të shmangen zgjedhjet e reja.

Ndërsa kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka njoftuar përmes një postimi në rrjetet sociale se ka refuzuar ftesën për takim me Kurtin, duke përmendur se ai veçse ka shprehur qëndrimin e partisë më 26 qershor, kur i shpalosi gjashtë kushtet e partisë në këmbim të mbështetjes për krijimin e institucioneve. "Më datën 26 qershor 2026, kam prezantuar publikisht ofertën tonë për mbështetjen e themelimit të institucioneve të reja të Kosovës. Aleanca është e gatshme, pa kushte ose kërkesa vetjake, të ndihmojë në bërjen e kuorumit për zgjedhjen e presidentit/es, nëse mandatarit për krijimin e Qeverisë i pranon gjashtë pikat e ofertës sonë. Kjo ofertë ka për qëllim që ta shtyjë përpara zhvillimin ekonomik të Kosovës, forcimin e pozitës ndërkombëtare të vendit dhe, njëkohësisht, të mos e dërgojmë vendin edhe njëherë në zgjedhje. Duke e pasur parasysh qëndrimin tonë të

qartë dhe parimor, nuk e shohim të nevojshëm takimin", ka deklaruar Gjini në shkresën që ia ka dërguar Kurtit.

Ajo që pritet pas certifikimit të rezultateve është konstituimi i Kuvendit, votimi i Qeverisë dhe zgjedhja e presidentit të ri të Kosovës. Për këtë të fundit, vendi kishte shkuar në zgjedhje, pasi muaj më parë partitë kishin dështuar të arrinin konsensus rreth kandidatit.

Sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 7 qershorit, LV-ja e Kurtit ka fituar 53 mandate, PDK-ja 22 ulëse, LDK-ja 18 dhe Aleanca shtatë. Meqë LV-ja duket se i ka votat për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë, nuk pritet që këto dy procese të hasin në pengesa, pasi për të dyja këto kërkohej 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh. Për këto dy procese, Kurti llogarit në votat e partive pakicë joserbe, të cilat kanë dhjetë mandate.

Megjithatë, ende nuk ekziston një marrëveshje apo konsensus rreth emrit të presidentit.

Cilat janë qëndrimet e partive?

Zyrtarja e lartë e LV-së, Arbërie Nagavci, ditë më parë ka thënë

se partia në pushtet i ka siguruar votat për formimin e Qeverisë së re dhe se do të kërkojë konsensus me partitë e tjera për zgjedhjen e presidentit.

PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca kanë paraqitur disa kushte për bashkëpunim të mundshëm me LV-në e Kurtit.

Hamza ka thënë se, para se të flitet për bashkëpunim të mundshëm qeverisës, janë një sërë temash, si pagat dhe pensionet, kapacitetet energjetike, gazi amerikan, anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, të cilat do të duhen të trajtohen me partinë fituese.

Abdixhiku, ndërkaq, ka thënë se orientimi strategjik i Kosovës, përfshirë gazin amerikan, "janë parakushti i ekzistencës politike" të LDK-së. Ndërsa Gjini ka paraqitur gjashtë kushte në këmbim të mbështetjes për krijimin e institucioneve të reja. Ndër kushtet e Aleancës janë që Kosova ta pranojë projektin e gazit amerikan, ndërtimin e një termocentrali me thëngjill dhe disa kushte të tjera që kanë të bëjnë me ekonominë.

Qeveria në detyrë e Kurtit po përballet me thirrje nga Ambasada amerikane, partitë opozitare dhe odat ekonomike që të bëhet pjesë e nismave

rajonale të rrjetit të gazit të lëngshëm natyror (LNG), të cilat mbështeten nga Shtetet e Bashkuara.

Më 8 korrik, e ngarkuara me punë në Ambasadën amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, ka përsëritur thirrjen që Kosova të furnizohet me LNG-në amerikane "për të siguruar investime amerikane në të ardhmen".

Megjithatë, deri më tani, nga ekzekutivi nuk kanë dhënë sinjale se janë të gatshëm të bëhen pjesë e këtyre nismave, ndërsa ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, dhe Kurti kanë përmendur idenë e gazifikimit të thëngjillit vendas.

Për presidentin nevojitet prania e dy të tretave të deputetëve në Kuvend, në mënyrë që votimi në dy rundet e para të jetë i vlefshëm. Në mungesë të një marrëveshjeje politike, kjo është e pamundur për secilën parti parlamentare. Kushtetuta parasheh që presidenti duhet të zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit.

Nëse kjo nuk ndodh, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja. Nëse vendi shkon sërish në zgjedhje, atëherë ato do të ishin të katërtat parlamentare që nga shkurti i vitit 2025.



GJYKATAT NË VERI ENDE PA GJYQTARË E PROKURORË SERBË: A KA ZGJIDHJE?

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka vlerësuar se rikthimi në punë i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb duhet të trajtohet si çështje me interes publik. Miftaraj ka thënë se rikthimi i tyre duhet të mbështetet në përgjegjësinë institucionale dhe në funksionimin e sistemit të drejtësisë, e jo të jetë rezultat i marrëveshjeve politike. Sipas tij, integrimi dhe funksionalizimi i institucioneve të drejtësisë duhet të udhëhiqet nga parimet profesionale dhe ligjore, me qëllim garantimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka vlerësuar se rikthimi në punë i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb duhet të shihet si çështje me interes publik. "Prania e tyre është thelbësore për funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë, qasjen e barabartë në drejtësi dhe rikthimin e besimit brenda komunitetit serb", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë". Por, Aleksandar Rapajiq nga Qendra për Avokimin e Kulturës Demokratike (ACDC), ka kujtuar se gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit serbë të sistemit të drejtësisë janë integruar në institucionet e Kosovës në vitin 2017, në bazë të një marrëveshjeje të arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ndaj edhe largimi i tyre nga institucionet e

Kosovës në vitin 2022 ishte rezultat i një vendimi politik. "Shumica e tyre do të ktheheshin në punë nëse do të arrihej një marrëveshje politike", ka thënë ai për "REL"-in. Në një konferencë të organizuar nga ACDC-ja më 29 qershor, me temën "Drejtësia në veri të Kosovës: Sfidat, përfaqësimi institucional dhe perspektivat e kthimit", është vlerësuar se rikthimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb mund të ndihmojë në rritjen e besimit të komuniteteve joshumicë në sistemin e drejtësisë. Përfaqësuesit e komunitetit serb ishin larguar kolektivisht nga institucionet e Kosovës në fund të nëntorit 2022, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për të hequr nga përdorimi targat e automjeteve të lëshuara nga

Serbia dhe për t'i zëvendësuar ato me targat e Kosovës. Përveç zyrtarëve policorë dhe punonjësve të administratës lokale, dorëheqje dhanë edhe rreth 130 gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë të sistemit të drejtësisë në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Çështja e dorëheqjeve të pazgjidhura është rikthyer në vëmendje pasi, në mes të qershorit, ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që "pa vonesa" t'i përmbyllin procedurat lidhur me këto dorëheqje, duke argumentuar se zvarritja e tyre ndikon në funksionimin normal të sistemit të drejtësisë. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", Këshilli Gjyqësor konfirmoi se e ka pranuar letrën më 19 qershor dhe se kjo çështje do të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore. Sipas KGJK-së, publiku do të njoftohet me kohë për vendimin. Këshilli Prokurorial, në anën tjetër, nuk i është përgjigjur kërkesës për koment. Largimi kolektiv i serbëve nga institucionet e Kosovës ishte iniciuar nga Lista Serbe, me mbështetjen e autoriteteve në Beograd. Punonjësit që kanë

dhënë dorëheqje, patën marrë kontrata të përkohshme dhe vazhdojnë të paguhen nga buxheti i Serbisë. Por, me kalimin e kohës, disa prej atyre që nuk mbështesnin Listën Serbe, kanë mbetur pa këto paga dhe njëkohësisht humbën mundësinë për t'u rikthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës. Pas krizave të shumta në veri të Kosovës, që kanë kulmuar me sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë në vitin 2023, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka bërë thirrje për rikthimin e serbëve në Policinë e Kosovës dhe në institucionet e drejtësisë. Edhe Lista Serbe, para zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar, ka pranuar se largimi nga institucionet e Kosovës kishte qenë gabim.

A kishte presion politik për kthimin?

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, ka vlerësuar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë vepruar me përgjegjësi, duke mos i pranuar dorëheqjet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb. Sipas tij, kjo ka ruajtur bazën ligjore që ata të mund të kthehen në detyrë pa kaluar në një proces të ri rekrutimi. Megjithatë, ai ka theksuar se rikthimi i tyre duhet të

mbështetet në përgjegjësinë institucionale dhe jo në marrëveshje politike. "Gjyqtarët dhe prokurorët e shërbejnë Kushtetutën dhe sundimit të ligjit, jo interesave politike", ka thënë Miftaraj. Aleksandar Rapajiq nga Qendra për Avokimin e Kulturës Demokratike (ACDC) ka thënë se Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje, ka ushtruar vazhdimisht presion ndaj Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial që t'i pranonin dorëheqjet, me qëllim që, sipas tij, "serbëve t'u mbyllej dera për t'u kthyer në sistemin e drejtësisë". "Ky ishte presion politik, por Këshilli Gjyqësor arriti t'i rezistojë. Ndërkohë, përbërja e Këshillit ka ndryshuar në kuadër të procedurës së rregullt, anëtarët e rinj janë zgjedhur nga Kuvendi dhe kam frikë se tani ekziston shumica e nevojshme për t'i miratuar këto dorëheqje", ka thënë Rapajiq.

A ka kush t'i zëvendësojë gjyqtarët dhe prokurorët serbë?

Rapajiq ka kujtuar se, deri më tani, janë pranuar dorëheqjet e vetëm dy gjyqtarëve, pasi ata janë angazhuar politikisht. Njëra prej tyre është ish-kryetarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Lilana Stevanović. Pas dorëheqjes, ajo ka marrë pjesë në

HARADINAJ KËRKON QË KOSOVA TA SYNOJË DISKUTIMIN E ANËTARËSIMIT NË NATO NË SAMITIN E TIRANËS

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ish-kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova duhet të veprojë menjëherë në mënyrë që në samitin e ardhshëm të NATO-s në Shqipëri të diskutohet kandidatura e saj për anëtarësim në këtë aleancë.

Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se, megjithëse koha është e shkurtër, me angazhim serioz ky synim është i arritshëm. Ai ka theksuar rëndësinë e NATO-s për Kosovën, duke e cilësuar atë si aleancën që e shpëtoi popullin e Kosovës nga gjenocidi dhe që vazhdon të ketë rol të rëndësishëm në sigurinë ndërkombëtare.

"Kosova duhet të veprojë menjëherë që në samitin e ardhshëm të NATO-s në Shqipëri të diskutohet kandidatura e saj për anëtarësim. Edhe pse koha është e shkurtër, me punë serioze ky synim është i arritshëm", ka shkruar Haradinaj. Sipas tij, mosmbështetja e këtij objektivit strategjik të Kosovës tregon mungesë vizioni ose moskuptim të përgjegjësive institucionale.



KONJUFCA TAKON ZYRTARIN E LARTË ITALIAN, NË FOKUS INTEGRIMI NË BE DHE NATO



PRISHTINË, 9 KORRIK - Zëvendëskryeministri dhe ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim zëvendësinistrin e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë, Edmondo Cirielli, me të cilin ka diskutuar për marrëdhëniet dypalëshe dhe zhvillimet aktuale politike. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), gjatë takimit është biseduar për

procesin e integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, anëtarësimin në NATO, si dhe për zhvillimet politike në vend, përfshirë procesin e formimit të qeverisë së re. Palët kanë diskutuar gjithashtu për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Italisë, me fokus rritjen e shkëmbimeve tregtare, intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

Konjufca e ka falënderuar

zëvendësinistrin italian për mbështetjen e vazhdueshme që Italia i ka dhënë Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit, duke theksuar se Italia mbetet një nga partnerët më të rëndësishëm ndërkombëtarë të vendit.

Sipas MPJD-së, takimi është zhvilluar në frymë miqësore dhe konstruktive, duke rikonfirmuar përkushtimin e të dyja vendeve për thellimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

protestat e organizuara nga Lista Serbe dhe më pas u përfshi edhe në listën zgjedhore të kësaj partie.

Sipas rezultateve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës, në zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit, ajo ka fituar afro 14 mijë vota, duke siguruar mandatin e deputetes. Por, sipas Rapajiqit, problemi më i madh do të lindte nëse do të pranoheshin edhe dorëheqjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë serbë. "Nuk do të ketë kush t'i zëvendësojë. Për t'u bërë gjyqtar duhen përgatitje me vite, ndërsa edhe gjyqtarëve të sapoemëruar u nevojiten vite përvojë për të marrë përgjegjësi të caktuara", ka thënë ai.

Edhe drejtori ekzekutiv i

ACDC-së, Dushan Radaković, ka ngritur të njëjtin shqetësim në konferencën për drejtësinë në veri të Kosovës. Sipas tij, nëse do të pranoheshin dorëheqjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, për gjashtë deri në tetë vjet nuk do të kishte kush t'i zëvendësonte. "Po flasim për përfundimin e studimeve, kalimin e provimit të jurisprudencës, konkurrimin për pozita, përvojën e punës, verifikimin e diplomave, emërimin, provimin për gjyqtarë dhe një vit praktikë, e kështu me radhë", ka thënë ai.

Radaković ka theksuar se, në pesë ose gjashtë afatet e fundit të provimit të jurisprudencës, vetëm një ose asnjë kandidat nga komuniteti serb arriti të kalonte provimin.

"Pas kthimit nuk duhet të përsëritet i njëjti skenar"

Miftaraj ka vlerësuar se integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë së Kosovës ishte një nga arritjet më të rëndësishme institucionale që nga shpallja e pavarësisë. Sipas tij, ky proces ka forcuar sundimin e ligjit, përmirësuar qasjen në drejtësi dhe ka rritur besimin e qytetarëve, veçanërisht në veri të Kosovës. "Largimi i tyre kolektiv, i nxitur nga rrethanat politike, e dëmtoi seriozisht funksionimin e sistemit të drejtësisë. Edhe pse gjykatat dhe prokuroritë vazhduan punën, një sistem që

funksionon pa përfaqësimin e duhur, nuk mund të garantojë plotësisht drejtësi efikase, të qasshme dhe të besueshme", ka thënë Miftaraj.

Ai ka vlerësuar se institucionet e Kosovës duhet t'u mundësojnë kthimin, por njëkohësisht t'u bëjnë të qartë se "vullneti i mirë institucional nuk mund të keqpërdoret pafundësisht". Sipas tij, synimi nuk është vetëm plotësimi i vendeve të lira të punës, por edhe forcimi i besimit të qytetarëve në një sistem të drejtësisë të pavarur, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Rapajiq, në anën tjetër, ka vlerësuar se ndërmjetësimi i Bashkimit Evropian është thelbësor për rikthimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, si dhe një

pjesë të zyrtarëve policorë në institucionet e Kosovës.

Ai është shprehur skeptik se një hap i tillë do të pranohej lehtë nga një qeveri e re e udhëhequr nga Kurti. Pas largimit të serbëve nga institucionet e Kosovës në vitin 2022, Kurti ka deklaruar se rikthimi i tyre nuk është çështje politike, por ligjore dhe kushtetuese. "Largimi i tyre ishte një akt individual. Rikthimi i tyre është çështje juridike, kushtetuese dhe institucionale", ka thënë ai. "Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar edhe Bashkimit Evropian për ta pyetur nëse në kuadër të dialogut është duke u diskutuar rikthimi i serbëve në institucionet e drejtësisë së Kosovës, por nuk ka marrë përgjigje.

Kosova ekstradon në Suedi një person të kërkuar për trafikim me narkotikë

PRISHTINË, 9 KORRIK - Policia e Kosovës ka realizuar ekstradimin në Suedi të një personi të kërkuar me letërrreshtim ndërkombëtar nga autoritetet suedeze.

Sipas njoftimit të Policisë, bëhet fjalë për shtetasin e

Kosovës dhe Suedisë me inicialet E.K., i cili ishte arrestuar në Kosovë pas një urdhër-arresti të lëshuar nga INTERPOL-i, me kërkesë të institucioneve të drejtësisë së Suedisë.

E.K. kërkohej nga autoritetet

suedeze nën dyshimin për veprën penale "Trafikim me narkotikë". Policia ka njoftuar se ekstradimi është realizuar nga Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në koordinim me njësitë përkatëse të Policisë së Kosovës dhe

institucionet e drejtësisë.

Sipas njoftimit, procedura është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe autoriteteve të Mbretërisë së Suedisë.



MINISTRI HOTI MIRATON DY UDHËZIME PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE



PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri në detyrë i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka njoftuar se ka nënshkruar dy udhëzime administrative në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Hoti ka bërë me dije se bëhet fjalë për Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e kushteve minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale dhe Udhëzimin Administrativ për procedurën e dhënies, përsëritjes, pezullimit dhe marrjes së

licencës për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.

Sipas tij, këto udhëzime vendosin rregulla më të qarta për themelimin dhe funksionimin e institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Hoti ka theksuar se miratimi i tyre përbën një hap të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe në garantimin e shërbimeve më cilësore, më

të sigurta dhe me standarde të njëjta për qytetarët. "Me këto udhëzime vendosen rregulla më të qarta për themelimin dhe funksionimin e institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Ky është një hap i rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe në garantimin e shërbimeve më cilësore, më të sigurta dhe me standarde të njëjta për qytetarët", ka thënë Hoti.

VENDOSEN KAMERA SIGURIE NË CËRNICË TË GJILANIT PËR RITJEN E SIGURISË PUBLIKE

GJILAN, 9 KORRIK - Komiteti Lokal për Siguri Publike (KLSP) në fshatin Cërnice, në bashkëpunim me Koordinatorin e Projekteve për Komunitet dhe Parandalim në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Gjilan, Njësinë e Policisë në Komunitet dhe Sektorin e Stacionit Policor në Gjilan, ka realizuar projektin për vendosjen e kamerave të sigurisë në këtë fshat. Projekti është financuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ndërsa mbështetje ka ofruar edhe Komuna e Gjilanit, e cila ka siguruar furnizimin me energji elektrike për funksionimin e sistemit të kamerave. Policia e Kosovës ka njoftuar se qëllimi i këtij projekti është rritja e nivelit të sigurisë publike,



parandalimi i veprave penale, mbrojtja e pronës dhe krijimi i një ambienti më të sigurt për qytetarët.

Sipas njoftimit, vendosja e kamerave është mirëpritur nga banorët e Cërnices, të cilët e kanë vlerësuar si një investim të rëndësishëm për sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit. Institucionet e përfshira kanë bërë me dije se do të vazhdojnë bashkëpunimin për realizimin e projekteve të tjera që kontribuojnë në përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve. Policia e Kosovës dhe Komiteti Lokal i Sigurisë në Cërnice kanë theksuar përkushtimin për identifikimin dhe adresimin e nevojave të komunitetit, me synim krijimin e një ambienti më të qetë dhe më të sigurt për të gjithë.

Policia në Mitrovicë nis fushatë kundër dhunës në familje: "Ta ndalojmë së bashku"

MITROVICË, 9 KORRIK - Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë dhe Jugut ka nisur një fushatë vetëdijësuese me moton "Ta ndalojmë së bashku", me qëllim parandalimin e dhunës në familje dhe nxitjen e qytetarëve për raportimin e rasteve të tilla. Gjatë fushatës, zyrtarët policorë po shpërndajnë materiale informuese për qytetarët në të gjithë zonën e përgjegjësisë së këtij rajoni. Fletushkat përmbajnë

informacione për format e dhunës në familje, shenjat që mund të tregojnë praninë e saj dhe mënyrat e raportimit.

Policia ka theksuar se dhuna në familje nuk duhet të trajtohet si çështje private, por si një vepër e papranueshme dhe e dënueshme me ligj. "Dhuna mund të shfaqet në forma të ndryshme, përfshirë dhunën fizike, psikologjike, emocionale, seksuale apo ekonomike. Çdo viktimë ka të drejtë të kërkojë mbrojtje dhe

mbështetje institucionale", është thënë në njoftimin e policisë.

Përmes kësaj fushate, policia ka bërë thirrje që qytetarët të mos heshtin përballë rasteve të dhunës, por t'i raportojnë ato në kohë. "Çdo informacion apo dyshim për raste të dhunës në familje mund të raportohet përmes numrit emergjent 192, në stacionet policore ose përmes aplikacionit 'Lajmëro Policinë'", është thënë në njoftim.



Ramiz Kelmendi nderohet për 22 vjet bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane

PRISHTINË, 9 KORRIK - Presidenti i "Elkos Group", Ramiz Kelmendi, ka pritur në një takim zyrtar drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet aktuale politiko-ekonomike dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit. Përmes një postimi në "Facebook", Kelmendi ka njoftuar se gjatë takimit ka pranuar një mirënjohje për bashkëpunimin 22-vjeçar

me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. "Kam pritur sot në takim zyrtar kreun e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, z. Arian Zeka, me ç'rast kam pranuar edhe Mirënjohje për bashkëpunim 22-vjeçar korrekt me këtë mekanizëm të rëndësishëm për ekonominë vendore", ka shkruar Kelmendi.

Ai ka thënë se gjatë takimit janë diskutuar tema që lidhen me zhvillimet politiko-ekonomike dhe mundësitë

për forcimin e marrëdhënieve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik. Kelmendi ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke e cilësuar atë strategjik për vendin. "Ruajtja, kultivimi dhe avancimi i bashkëpunimit ekonomik dhe të gjithëmbarshtëm Kosovë-ShBA mbetet jetik për Kosovën dhe popullin tonë", ka shkruar presidenti i "Elkos Group".



TEMPERATURAT E LARTA PENGOJNË SEANCAT NË PALLATIN E DREJTËSISË, KGJK-ja AUTORIZON MASA PËR REDUKTIM TË PUNËS

PRISHTINË, 9 KORRIK - Problemet me sistemin e klimatizimit në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë po vazhdojnë të vështirësojnë punën e gjykatave, ndërsa temperaturat e larta në sallat gjyqësore kanë ndikuar edhe në shtyrjen e disa seancave.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka njoftuar se sanimi i plotë i sistemit të klimatizimit kërkon kohë dhe mjete të konsiderueshme financiare. Ndërkohë, janë ndërmarrë disa ndërhyrje të pjesshme për përmirësimin e gjendjes. Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Besim Spahi, ka thënë se për këtë problem ka kërkuar reagim nga menaxhmenti i gjykatës, sekretariati dhe KGJK-ja. Sipas tij, pas kërkesave të tij është realizuar një sanim i vogël i sistemit të klimatizimit.



Spahi ka thënë se më 10 qershor i është drejtuar institucioneve përkatëse lidhur me mungesën e klimatizimit, ndërsa më pas është informuar se është angazhuar një ekip për sanimin e problemit. Ai ka shtuar se për një rregullim të plotë nevojiten mjete buxhetore që aktualisht nuk janë në dispozicion. Pas përkeqësimit të kushteve,

sindikata ka kërkuar edhe reduktimin e përkohshëm të orarit të punës. Spahi ka mirëpritur vendimin e KGJK-së për t'u lejuar gjykatave të ndërmarrin masa nëse paraqitet nevoja. Vështirësitë në sallat gjyqësore i ka konfirmuar edhe avokati Arbër Jashari, i cili ka thënë se temperaturat e larta kanë bërë të pamundur vazhdimin e një

seance të planifikuara gjatë gjithë ditës në Departamentin për të Mitur. Sipas tij, gjatë seancës njëra nga palët gati është alivanosur për shkak të temperaturave të larta, ndërsa mungesa e ajrosjes e ka bërë edhe më të vështirë qëndrimin në objekt. Për këtë arsye, seanca është shtyrë për një ditë tjetër.

Jashari ka thënë se Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka shtyrë pothuajse të gjitha seancat që nuk janë konsideruar urgjente. Sipas tij, shtyrja e seancave ndikon drejtpërdrejt në të drejtat e palëve në procedurë penale, përfshirë të drejtat e të pandehurve dhe palëve të dëmtuara.

Ndërkohë, zëdhënësjja për media e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi, ka thënë se gjatë ditëve të fundit është vërejtur përmirësim i

gjendjes në ambientet e punës dhe se sistemi i klimatizimit ka filluar të funksionojë.

Sipas saj, gjykata aktualisht nuk e konsideron të nevojshme reduktimin ose pezullimin e punës, por do ta monitorojë situatën dhe, nëse paraqitet nevoja, do të zbatojë masat e autorizuara nga KGJK-ja për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së gjyqtarëve, stafit dhe palëve.

Të hënën, KGJK-ja ka autorizuar kryetarët e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Administrative, Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë që të ndërmarrin masa për shkak të temperaturave të larta në Pallatin e Drejtësisë.

Sipas vendimit, kryetarët e gjykatave mund të reduktojnë ose pezullojnë përkohësisht punën, në varësi të vlerësimit të situatës dhe kushteve në objekt.

MASH-i NDAN 100 BURSA PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PROFESIONAL

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) do të vazhdojë edhe gjatë vitit shkollor 2026/2027 mbështetjen për nxënësit e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP), përmes ndarjes së 100 bursave. Sipas MASH-it, kjo masë synon të nxisë regjistrimin e nxënësve në profilet deficitare dhe të rrisë pjesëmarrjen e vajzave në drejtimet teknike,

në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Bursat u dedikohen nxënësve të klasës së dhjetë në institucionet e Arsimit dhe Aftësisit Profesional dhe kanë vlerë prej 50 eurosh në muaj, ose 500 euro për një vit shkollor, pa përfshirë muajt korrik dhe gusht.

MASH-i ka njoftuar se mbështetja financiare do të vazhdojë për tri vite të



shkollimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Nga gjithsej 100 bursat e ndara, 70 do t'u jepen nxënësve që regjistrohen në drejtimet deficitare, ndërsa 30 janë të rezervuara për vajzat që zgjedhin drejtimet teknike. Afati për aplikim është nga 9 korriku deri më 1 tetor 2026. Nxënësit duhet të dorëzojnë aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës në

institucionet e Arsimit dhe Aftësisit Profesional, ndërsa drejtuesit e këtyre institucioneve do t'i përcjellin aplikimet në MASH deri më 5 tetor 2026. Sipas ministrisë, kjo iniciativë synon të kontribuojë në orientimin e të rinjve drejt profesioneve që kanë kërkesë më të madhe në tregun e punës dhe në forcimin e arsimit profesional në Kosovë.

ShSKUK-së i bashkohen 17 anesteziologë të rinj

PRISHTINË, 9 KORRIK - Sistemi publik shëndetësor i Kosovës është përforcuar me 17 anesteziologë të rinj, të cilët do t'i bashkohen Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe

përmirësimin e ofrimit të shërbimeve mjekësore.

ShSKUK-ja ka njoftuar se anesteziologët në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në spitalet e përgjithshme ofrojnë shërbime 24 orë në ditë, duke pasur rol të rëndësishëm në

ndërhyrjet kirurgjikale, kujdesin intensiv dhe trajtimin e rasteve urgjente. Sipas njoftimit, angazhimi i 17 specialistëve të rinj pritet të forcojë mbështetjen për sallat operative, njësitë e kujdesit intensiv, repartet emergjente dhe shërbimet e tjera spitalore

në kuadër të ShSKUK-së. Ky përforcim i stafit mjekësor synon të ndikojë në rritjen e efikasitetit të trajtimit të pacientëve dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike të Kosovës.



Haxhiu viziton ZKA-në: Do ta mbështesim transparencën dhe menaxhimin e përgjegjshëm të parasë publike

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka vizituar Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), ku është pritur nga Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, dhe stafi i institucionit. Haxhiu ka vlerësuar rolin e ZKA-së në

forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, duke theksuar se auditimi i pavarur është një nga shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë. Sipas saj, gjatë takimit është diskutuar për njohjet ndërkombëtare të ZKA-së, bashkëpunimin me Prokurorinë në trajtimin e

gjeteve të auditimit, si dhe ndryshimet ligjore që synojnë forcimin e pavarësisë institucionale. "Do të vazhdoj të mbështes çdo përpjekje që forcon integritetin, transparencën dhe menaxhimin e përgjegjshëm të parasë publike", ka shkruar Haxhiu në rrjetet sociale.



BE-ja MIRATON PROJEKTE DHE GRANTE PREJ 206 MILIONË EUROSH PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) ka miratuar projekte dhe grante në vlerë të përgjithshme prej 206 milionë eurosh për Kosovën. Sipas Kurtit, BE-ja e ka njoftuar zyrtarisht Kosovën se Komiteti i IPA-s ka miratuar projektet e propozuara në kuadër të programeve IPA 2026 dhe IPA 2027, në vlerë prej 180.5 milionë eurosh. Po ashtu, janë miratuar edhe tri grante nga Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF), në vlerë totale prej 25.9 milionë eurosh.

Megjithatë, fondet do të mund të disbursohen vetëm pasi të

miratohen nga Komisioni Evropian dhe të nënshkruhet e ratifikohet marrëveshja financiare nga Kuvendi i Kosovës.

Kurti ka thënë se fondet prej 180.5 milionë eurosh do të mbështesin sektorë prioritarë, si mjedisi dhe klima, energjia, menaxhimi i kufijve dhe migrimi, konkurrueshmëria, arsimit dhe punësimi, qeverisja e mirë, përafrimi me Bashkimin Evropian dhe sundimi i ligjit.

Ai ka thënë se rreth gjysma e mjeteve do të investohen në projekte infrastrukturorë, ndërsa shumica e tyre do të realizohen në bashkëpunim me partnerë zhvillimorë dhe me



bashkëfinansim nga institucionet e Kosovës.

Nga grantet e WBIF-së, investimet do të përqendrohen në rehabilitimin e hidrosistemit Ibër-Lepenc, ndërtimin e segmentit autostradë Qafë e Duhlës-Banullë dhe ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Kosova përfiton nga fondet e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) që nga viti 2007. Deri në fund të vitit 2022, vendi ka përfituar gjithsej 1.21 miliardë euro përmes programeve IPA I dhe IPA II.

MINTI DHE INSTITUTI GAP SHQYRTOJNË BASHKËPUNIMIN PËR POLITIKAT ZHVILLIMORE DHE INTEGRIMIN EVROPIAN



PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministrija e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e Institutit GAP, Blendi Hasaj dhe Nora Latifi Jashari, ku është diskutuar mundësia e bashkëpunimit në kuadër të agjendës së reformave të ministrisë.

Sipas MINTI-t, në takim është diskutuar roli që Instituti GAP mund të ketë përmes ekspertizës së tij në mbështetje

të politikave zhvillimore në fushën e industrisë, ndërmarrësisë dhe inovacionit. Një nga temat kryesore ka qenë Mekanizmi i Rregullimit Kufitar të Karbonit (CBAM) i Bashkimit Evropian dhe nevoja për informimin e bizneseve në Kosovë lidhur me detyrimet që burojnë nga ky mekanizëm, veçanërisht në proceset e monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV). Palët kanë diskutuar edhe mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet

MINTI-t, odave ekonomike dhe Institutit GAP, si dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në hartimin dhe rishikimin e strategjive zhvillimore. Ministrija Kusari-Lila ka theksuar se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile është thelbësor për avancimin e reformave, rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike dhe përsheptimin e procesit të integrimit evropian të Kosovës.

ATK-ja publikon versionin e ri të EDI-së, shtohet shërbimi "Kërkesë për Fiskalizim"

PRISHTINË, 9 KORRIK - Softuerëve Elektronikë Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka publikuar versionin e ri të Sistemit Elektronik "EDI", i cili sjell një shërbim të ri elektronik për tatimpaguesit – "Kërkesë për Fiskalizim".

Sipas ATK-së, shërbimi i ri është funksionalizuar në zbatim të Udhëzimit Administrativ (MF) Nr. 01/2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe

Softuerëve Elektronikë Fiskalë. Qëllimi i tij është pajisja e tatimpaguesve me Kodin Unik për Fiskalizim, i cili është i nevojshëm për përdorimin e Softuerit Elektronik Fiskal (SEF).

Përmes këtij shërbimi mund të aplikojnë tatimpaguesit që planifikojnë të fillojnë përdorimin e SEF-it, si dhe ata që janë në proces të kalimit nga Pajisjet Elektronike Fiskale (PEF) në Softuerin Elektronik Fiskal.

Shërbimi është i qasshëm në Sistemin Elektronik EDI, në menynë "Fiskalizimi", përmes opsionit "Kërkesë për Fiskalizim".

ATK-ja ka njoftuar se tatimpaguesit që tashmë janë pajisur me Kodin Unik për Fiskalizim do ta kenë atë të shfaqur në sistem, ndërsa ata që ende nuk e kanë këtë kod mund të parashtrajnë kërkesën në mënyrë elektronike përmes shërbimit të ri.



Administrata Tatimore u ka bërë thirrje të gjithë tatimpaguesve që do të përdorin Softuerin Elektronik

Fiskal, si dhe atyre që po kalojnë nga PEF në SEF, që të verifikojnë statusin e tyre në Sistemin Elektronik EDI dhe, nëse është e nevojshme, të aplikojnë për pajisjen me Kodin Unik për Fiskalizim.

Sipas ATK-së, publikimi i versionit të ri të EDI-së është pjesë e përpjekjeve për digjitalizimin e proceseve tatimore dhe për ofrimin e shërbimeve më moderne, efikase dhe më të qasshme për tatimpaguesit.

NGA LAVDIA TE PASIGURIA: ÇFARË TRASHËGOI IRANI PAS 37 VITEVE TË KHAMENEI-T?

Faza e fundit e ceremonive mortore këtë të enjte, 9 korrik, për ish-liderin suprem Ajatollah Ali Khamenei, në faltoren më të shenjtë të vendit, ndërsa djali dhe pasardhësi i tij, Mojtaba Khamenei, vijon të qëndrojë larg syrit të publikut, pas plagëve të rënda që mori në sulmin ku humbi jetën i ati. Ceremonia zhvillohet në Mashhad, në verilindje të Iranit, disa ditë pas një serie procesionesh masive mortore, tubimesh dhe ceremonish zie, të cilat janë zhvilluar paralelisht me rifillimin e tensioneve dhe përplasjeve me Shtetet e Bashkuara pas një periudhe armëpushimi. Protestuesit mbanin flamuj iranianë, fotografi të Khamenei-t dhe pankarta me slogane revolucionare. Megjithatë, pavarësisht se

Teheran, Mojtaba Khamenei ka pësuar dëmtime të rënda në të njëjtin sulm, me plagë serioze në fytyrë dhe gjymtyrë. Burimet thonë se ai është në fazën e rikuperimit, por ende nuk është në gjendje të flasë publikisht. Shërbimet e sigurisë po përpiqen gjithashtu të kufizojnë ekspozimin e tij, nga frika e sulmeve të tjera amerikane. Gjatë ceremonive, trupi i Khamenei-t është transportuar në disa qytete të Iranit dhe Irakut, ndërsa udhëheqësit klerikë të Republikës Islamike kanë nxitur pjesëmarrje masive për të treguar forcën dhe ndikimin ideologjik të regjimit. Në Mashhad, teksa turma priste kortezhin mortor, mijëra persona brohoritën slogane hakmarrjeje ndaj presidentit amerikan Donald




Iranin, duke shënuar fundin e një epoke gati 4 dekada të udhëheqjes së Khamenei-t, disa muaj pas protestave të mëdha mbarëkombëtare kundër Republikës Islamike. Forcat e sigurisë shtypën protestat, të nxitura nga pakënaqësia për krizën ekonomike dhe pasojat e sanksioneve ndërkombëtare, duke shkakuar një valë dhune që rikujtoi përplasjet e mëparshme mes autoriteteve dhe opozitarëve. Analistët vlerësojnë se Irani ka dalë nga konflikti me një pozicion më të fortë strategjik, duke ruajtur kontrollin mbi ngushticën e rëndësishme të Hormuzit, por vendi ka pësuar dëme të mëdha që kanë rënduar më tej problemet ekonomike. Ali Khamenei u emërua lider

suprem në vitin 1989, një dekadë pas Revolucionit Islamik, dhe gjatë dekadave në pushtet forcoi ndjeshëm kontrollin politik, ekonomik dhe ushtarak të institucionit që drejtonte. Ky proces, i cili dobësoi gjithnjë e më shumë rolin e presidentit dhe parlamentit të zgjedhur, u zhvillua paralelisht me rritjen e ndikimit të Gardës Revolucionare Islamike, e cila u shndërrua në një nga forcat kryesore të pushtetit në Iran. Mojtaba Khamenei u emërua në krye të udhëheqjes me mbështetjen e Gardës Revolucionare, e cila sot konsiderohet si një nga aktorët më të fuqishëm në përcaktimin e politikës dhe strategjisë së Iranit.

regjimi iranian ka mbijetuar pas sulmeve të vazhdueshme nga armiqtë e tij më të fuqishëm, Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli, vendi përballlet me sfida të mëdha të brendshme. Trashëgimia e sundimit 37-vjeçar të Khameneit mbetet një çështje e debatueshme në shoqërinë iraniane. Vendndodhja e Mojtaba Khamenei-t, i shpallur lideri i ri suprem nga një asamble klerikësh një javë pas vdekjes së babait të tij, mbetet ende mister për qytetarët iranianë. Ai nuk është shfaqur në publik që prej fillimit të luftës dhe sulmit që vrau Ali Khamenei-n më 28 shkurt. Edhe pse ka publikuar disa deklarata me shkrim, autoritetet nuk kanë publikuar asnjë pamje, video apo regjistrim zanor të tij. Sipas burimeve të larta në

Trump, duke e akuzuar për vrasjen e liderit suprem. “Betohe mi për gjakun e liderit suprem, Trump, do të të vrasim!”, kanë thirrur disa pjesëmarrës, ndërsa gra në turmë mbanin pankarta me mbishkrimin “Vriteni Trumpin”. Në çdo ceremoni, mijëra njerëz kanë mbushur rrugët, ndërsa janë dëgjuar vajtime fetare shiite dhe slogane revolucionare. Martirizimi zë një vend qendror në traditën shiite dhe vdekja e Khamenei-t nga një sulm i atribuar armiqve të huaj është përdorur nga udhëheqja iranianë për të forcuar narrativën fetare dhe politike të Republikës Islamike. Varrimi i liderit suprem vjen në një moment kritik për





Ballkani barazon në Uells, gjithçka mbetet e hapur për ndeshjen kthyese

CONNAH'S QUAY, 9 KORRIK - Ballkani ka barazuar pa gola (0:0) në përballjen e parë ndaj Connah's Quay Nomads, në kuadër të raundit të parë kualifikues të Ligës së Konferencës. Skuadra nga

Suhareka ka zhvilluar një paraqitje të mirë në Old Colwyn të Uellsit, duke ruajtur portën e paprekur dhe duke lënë të hapur çështjen e kualifikimit për sfidën e kthimit. Ndeshja e kthimit do

të zhvillohet më 16 korrik në Prishtinë, ku Ballkani do të synojë ta shfrytëzojë përparësinë e terrenit vendas për të siguruar kalimin në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës.



ALBION RRAHMANI BËHET LOJTAR I KLUBIT ITALIAN VENEZIA

VENEZIA, 9 KORRIK - Ylli i Kombëtares së Kosovës dhe Spartës së Pragës, Albion Rrahmani është bërë me skuadër të re. Të enjten, ai është zyrtarizuar te ekipi i Serie A, Venezia. Klubi Italian e ka prezantuar ish-sulmuesin e Ballkanit, duke njoftuar për kompletimin e transferimit të tij. Detajet e transferimit ende nuk janë bërë të ditura, por sipas raportimeve,

marrëveshja mes dy klubeve është arritur për 7.5 milionë euro, ndërsa përmes bonuseve vlera totale e transferimit mund të arrijë deri në 9.5 milionë euro. Gjithashtu, Sparta e Pragës do të mbajë edhe 10 për qind të shumës nga një shitje e ardhshme e sulmuesit kosovar.

Rrahmani, i cili muajin e ardhshëm mbush 26 vjeç, i



është bashkuar Spartës së Pragës dy vjet më parë nga FC Rapid 1923 për rreth pesë milionë euro.

Gjatë aventurës së tij në Çeki, ai ka zhvilluar një sezon të suksesshëm duke realizuar 16 gola dhe katër asistime në 49 ndeshje zyrtare. Sulmuesi i Kosovës është dalluar edhe në UEFA Europa Conference League, ku ka shënuar katër gola në 13 paraqitje, duke

tërhequr vëmendjen e disa klubeve evropiane. Në anën tjetër, Venezia rikthehet këtë sezon në Serie A pas triumfit në Serie B, ndërsa trajneri Giovanni Stroppa synon të përforcojë repartin ofensiv përpara fillimit të edicionit të ri. Albion Rrahmani ka luajtur edhe për Malishevën dhe Ballkanin, përpara se të niste karrierën në skuadra evropiane.

TRI KLUBE ITALIANE PAS VOJVODËS



COMO, 9 KORRIK - Repreruesi i Kosovës, Mërgim Vojvoda është njëri prej futbollistëve më të kërkuar në tregun italian. Hiq më pak se tri klube, kanë shprehur interesim dhe janë në garë për transferimin e Vojvodës gjatë kësaj vere, ka raportuar "Calciomercato".

Cagliari, Parma dhe Venezia, janë skuadrat që po insistojnë për Vojvodën, i cili ka kontratë me Comon deri në verën e vitit 2028. 31-vjeçari po shihet si përforsim i duhur për krahun, duke pasur parasysh se ka përvojë të madhe në futbollin italian. Vojvoda

është pjesë e Comos prej fillimit të vitit 2025 kur iu bashkua nga Torino, ekip për të cilin ka luajtur për gati pesë sezone. Deri më tani, Vojvoda ka regjistruar 168 paraqitje në elitën e futbollit italian, ku ka shënuar 5 gola dhe ka bërë 17 asistime.

MISINI TRANSFEROHET TE BAYER LEVERKUSENI

LEVERKUSEN, 9 KORRIK - Lumbardha Misini do ta vazhdojë karrierën në Gjermani, pasi është transferuar te Bayer 04 Leverkusen. Klubi zviceran Servette FCCF ka njoftuar zyrtarisht se ka arritur marrëveshje me klubin gjerman për transferimin e futbollistes nga Kosova. Sipas njoftimit të Servettes, ky është transferimi më i madh

në historinë e klubit, duke u bërë shitja më e rëndësishme e realizuar ndonjëherë nga skuadra zvicerane.

Misini i ishte bashkuar Servettes verën e kaluar nga klubi turk Trabzonspor dhe, gjatë një sezoni me fanellën "granate", zhvilloi 25 paraqitje, duke lënë gjurmë me paraqitjet e saj dhe duke tërhequr vëmendjen e njërit prej klubeve më të mëdha të



futbollit gjerman. Transferimi te Bayer Leverkuseni përfaqëson një hap të madh në karrierën e futbollistes kosovare, e cila tashmë do të ketë mundësinë t'i dëshmojë cilësitë e saj në Bundesligën gjermane, një nga kampionatet më të forta të futbollit të femrave në Evropë. Në klubin e ri, Misini do ta bartë fanellën me numrin 34, të njëjtin numër

që e mbante Granit Xhaka te Bayer Leverkusen në sezonin historik, kur klubi e fitoi titullin e parë në Bundesliga. Ky transferim është një sukses i rëndësishëm jo vetëm për Lumbardha Misinin, por edhe për futbollin e Kosovës, pasi konfirmon rritjen e vazhdueshme të futbollisteve të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Brajan Gruda do të luaj sërish në Bundesliga

LEIPZIG, 9 KORRIK - Saga e transferimit të Brajan Grudës ka marrë fund. Mesfushori shqiptar do të vazhdojë të jetë pjesë e RB Leipzig sezonin e ardhshëm. Sipas raportimeve të "Sky", klubi gjerman ka arritur një marrëveshje në parim me Brighton & Hove Albion për transferimin e 22-

vjeçarit, i cili pritet të rikthehet në Bundesligë. Marrëveshja parashikon një huazim me detyrim blerjeje, i cili do të aktivizohet në varësi të disa kushteve të përcaktuara. Në rast se ato plotësohen, Leipzig pritet t'i paguajë Brightonit një shumë prej 25 deri në 30 milionë euro.

Gruda e njez ambientin e Leipzigut, pasi ishte pjesë e skuadrës gjermane në huazim gjatë gjysmës së dytë të sezonit të kaluar. Ai zhvilloi 14 paraqitje, duke realizuar tre gola dhe duke dhuruar tre asistime. Brighton e kishte transferuar talentin shqiptar nga Mainz 05 dy vite më parë

për mbi 31 milionë euro, por aventura e tij në Angli nuk shkoi sipas pritshmërive, pasi nuk arriti të siguronte një rol të rëndësishëm në skuadër. Tashmë, Gruda do të ketë mundësinë të rifillojë në Bundesligë, aty ku pritet të kërkojë vazhdimësi dhe të tregojë potencialin e madh që



e ka shoqëruar prej fillimit të karrierës.

An advertisement for RC cola. At the top center is the RC logo with "ROYAL CROWN" above it. Below the logo is a yellow banner with the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". On the left, a dark blue box contains the following text:

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

On the right, a blue RC can and a dark RC bottle are shown on a wooden surface. The can and bottle both feature the RC logo and "Columbus, Georgia, USA".

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

